



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.11.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eing-Com" për aktivitetin: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" dhe me numër të prokurimit: 616-18-5173-121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono**"Eing Com"** e datës 16.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121,Nr. Brendshëm 616 18 083 121 211 kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit*, të datës 04.11.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për anulim të aktivitetit* i publikuar me datë: 04.11.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj respektimin e Vendimit për anulim të aktivitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"Eing Com"** me datë 16.11.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121 Nr. Brendshëm 616 18 083 121".

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.11.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara pasi që në asnjë rast Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar tejkalimin e vlerës së parashikuar, sepse në këtë rast as OSHP-JA e as ne nuk mund të bëjmë vlerësim të tillë, pasi që tenderi i shpallur ka të bëjë me

çmimin për copë dhe vlerën totale,por në asnjë rast nuk është cekur sasia e paraparë për furnizim dhe në këtë rast nuk mund të flitet për asnjë lloj tejkalimi:

-Tejkalimet kanë të bëjnë me proporcionin e pozicioneve të parashikuara nga ne dhe çmimet e ofruara manipuluese nga ju dhe këtë ua kemi sqaruar edhe në Vendimet paraprake;dhe

-Nga ju është kërkuar sqarimi lidhur me çmimet e ofruara sipas pjesëve,ku dominon fakti se ju keni ofruar çmim shumë më të ulët për pjesën që kushton shumë më shtrenjtë dhe anasjelltas çmim shumë më të lartë për pjesën më të lirë,me qëllimin e vetëm që çmimi i poentuar të jetë i favorshëm për ju dhe i pafavorshëm për Komunën.Në sqarimin tuaj keni shkruar se është e drejtë e juaja të vendosni çmimet dhe se kjo është sekret i juaji duke harruar se Autoriteti Kontraktues si Institucion Publik ka të drejtën ligjore të marr sqarimet tuaja,të cilat ju nuk i keni ofruar edhe pse keni obligim ligjor.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për anulim ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit